




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 463/2022

Datë: 24 nëntor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 13 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e 299-të, të mbajtur me datë 24 nëntor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Luan Berisha, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, caktohet kryesues i panelit hetimor për rastin Nr.AD/KGJK/16/2022/GJTHFR-AD/GJTHF.nr.08/2022.
2. Siniša Borislavljevic, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, anëtar i të njëjtit panel hetimor.
3. Vendimi hynë në fuqi me datë 24 nëntor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 15 nëntor 2022, ka pranuar njoftimin përmes postes elektronike nga Veljko Vucetic, gjyqtari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, i cili me vendimin e Këshilli KGJK.nr.370/2022, ka qenë i caktuar Kryesues i panelit hetimor për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/16/2022/GJTHFR-AD/GJTHF.nr.08/2022. Me këtë njoftim gjyqtari Vucetic e ka njoftuar Këshillin se nuk mund të vazhdoj punën si Kryesues i panelit hetimor pasi ka dhënë dorëheqja nga pozita e gjyqtarit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 24 nëntor 2022, pasi e shqyrtoj njoftimin e gjyqtarit Veljko Vucetic, vlerësoj se kërkesa për përjashtim është e arsyeshme dhe njëzëri të njëjtën kërkesë e miratoj.

Këshilli, si kryesues për të shërbyer në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/16/2022/GJTHFR-AD/GJTHF.nr.08/2022, caktoj Luan Berisha, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, qe ka qenë anëtar i panelit të njëjtit dhe në vend të tij si anëtar ka caktuar Siniša Borislavljevic, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.



Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Luan Berisha, gjyqtar në gjykatën Themelore në Prizren;
- Siniša Borislavljevic, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë;
- Anëtarëve të Panelit Hetimor